

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Harmony Hotel**

Sot në datën 24.01.2022 , Artan Zhiva, shtetas shqiptar, banues në Pogradec, me nr personal H11111044N , me cilësinë e ortakut të vetëm themelues, në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe Legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë , nëpërmjet nënshkrimit të këtij akti themelimi ka vendosur të themelojë Shoqerinë me Përgjegjësi të Kufizuar "Harmony Hotel". Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë**

1.1 Është themeluar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e quajtur Harmony Hotel, këtej e tutje referuar edhe si Shoqëria.

1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2
Selia e Shoqërisë**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr e Vilave, Nr Pasurie 8/2/5, Buçimas, Pogradec.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë, me autorizim të Asamblesë, mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 4 **Objekti**

4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:

- a. Veprimitari në fushën e strukturave akomoduese hoteleri, bar restoran, beach bar, me plan shërbimi të personalizuar dhe plan shërbimi "çdo gjë e përfshirë" (all inclusive), shezzone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, transport, organizim i tureve guidave të ndryshme turistike, zhvillim i panaireve, seminareve dhe workshopeve, shërbime opsonale plotësuese me karakter çlodhje, pushimi apo dëfrimi, spektakli, lojra, organizime dhe realizime eventesh të ndryshme, shërbime Spa, shërbim parkimi etj.
- b. Projektim dhe ndërtim i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë. Punime hidraulike. Ndërtim rrjetesh elektrike dhe panele diellore. Si dhe çdo veprimitari tjetër në funksion të qëllimit të biznesit;
- c. Veprimitari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to.
- d. Shfrytëzimin e zonave breglienore, malore apo bregdetare, plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.;
- e. Shitja e objekteve / njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira;
- f. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimitarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 5 **Kapitali - Kuotat**

- 5.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë është Artan Zhiva me 100 % të kuotave të kapitalit.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100000 LEKË (njëqind mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 100,000 LEKË (njëqind mijë lekë) secila.
- 5.3 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
 - Artan Zhiva ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 100,000 lekë (njëqind mijë lekë).
- 5.4 Artan Zhiva, zoteron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalitthemeltar të Shoqërisë.
- 5.5 Ortaku/ secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

Neni 6 **Transferimi i Kuotave**

- 6.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 6.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përvçese kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

Neni 7 **Administratori/ët**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përvçese kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nësë Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpëra mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovalitet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushton të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, date 14 mars 2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokure speciale ('ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.



- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
- Artan Zhiva, shtetas shqiptar, i lindur më 11.11.1971, banues ne Pogradec, me numër personal H11111044N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8
Dispozita të fundit

8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Legjislacionit Shqiptar.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Pala deklaron se ky Akti Themelimi, është në përputhje me vullnetin e tij dhe për këtë arsy e nënshkruan atë në datën e sipërshënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

Miratuar nga :

Ortaku Themelues

Artan Zhiva

Artan Zhive

